



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) dhe 14, lidhur me nenin 40, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), lidhur me nenin 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, -----, miraton këtë;

### **Projekt-V E N D I M**

#### **Neni 1**

Me këtë vendim bëhet ndryshimi i emërimit të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronës në librin kadastral, pasi që në certifikatën e pronësi figurojnë me emërtime të vjetra.

#### **Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe regjistri i shkollave me emërtime të vjetra sipas fletës poseduese në kadastrë e për të cilat kërkohet ndryshimi i emërimit sipas emrave aktual të shkollave, regjistri me numër të protokollit 01-Nr-104-66670 të datës 12.10.2023, i përpiluar nga Drejtoria e Arsimit.

#### **Neni 3**

Obligohet Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë e Komunës së Suharekës, që të bënë ndryshimet e emërtimeve në librat kadastrale, sipas regjistrin të cekur në nenin 2, të këtij vendimi.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Suharekës.

#### **Neni 5**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## **KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Më datë\_\_\_\_\_

**Kryesuesi i Kuvendit**  
\_\_\_\_\_  
**Mr.ec Bexhet KUÇI**